



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:061493
Datë: 03.12.2024
Numri i dokumentit: 06539362

Ac.nr.7220/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses BKS me seli ne P....., rr. “L..... e P.....”, Magjistratja P.....F..... K....., pa nr., kundër të paditurit A.(J) M nga F....., Rruga ,, N..... “ nr..... , më bazë rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 2,074.00 euro, duke vendosur lidhur më ankesën e të paditurit , e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.858/2020, i datës 30.08.2022, në seancën jo publike të mbajtur me datë 02.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit A.(J) M nga F....., Rruga ,, N..... “ nr..... , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.858/2020, i datës 30.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.858/2020 i datës 30.08.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në P..... rr:”L..... e P.....”, Magjistratja P.....-F..... K....., si e bazuar. II. DETYROHET i padituri A(J) M, rruga ,, N..... “ nr.në F....., që paditëses t’ia paguaj shumën prej 2,074.00 € (dymijë e shtatëdhjetë e katër) euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 23.10.2017, me kamatë ligjore prej 8% nga data 30.08.2020, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta anulojë dhe çështjen ta kthej në rigjykim, apo që gjykata e shkallës së dytë të vendos vet mbi çështjen.

Përgjigje në ankesë nuk pati.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa nuk është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të saj me datë 02.06.2020, në gjykatën e shkallës së parë, kundër të paditurit ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar rimbursimin e dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesës nga padia, në pajtim me nenin 150 të LPK-së, jashtë seance më datë 30.08.2022 nxjerrë aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes) C.nr.858/2020 më të cilin aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, e duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452.1 të LPK.

Lidhur më mënyrën e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në kuptim të nenit 394 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i kishte dërguar të paditurit padinë, provat materiale dhe Aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi. Duke bërë shikimin në fletë dërgesën ka konstatuar se i padituri aktvendimin për përgjigje në padi se bashku me provat shkresore i kishte pranuar në mënyrë të rregullt më datë 17.12.2020, mirëpo edhe pse kishte kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e kishte parashtruar përgjigjen në padi. Në rrethanat e tilla duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së ka gjetur se plotësohen kushtet ligjore për nxjerrje të aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes) pasi që janë plotësuar 3 kushtet të cilat përcaktohen më ligj dhe atë poshtë: a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja –Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi, b)Themelësia e kërkesëpadisë rezulton nga faktet e treguara në padi dhe c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësja.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore aktgjykim nuk janë treguar arsytet për faktet vendimtare, dhe ato arsye të cilat janë dhënë janë të paqarta si dhe në faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie, pasi që Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret kanë qenë të plotësuara të gjitha kushtet ligjore nga neni 150.1 të LPK-së, për nxjerrje të aktgjykimit për shkak të mosbindjes/padëgjueshmërisë, ngase me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se të paditurit nga gjykata e shkallës së parë i është dorëzuar në mënyrë të rregullt Aktvendimi për të dhënë përgjigje në padi, bashkë me një kopje të padisë dhe provave të bashkangjitura padisë, të cilat i padituri del ti ketë pranuar në mënyrë të rregullt më datë 17.12.2020. Përveç tjerash gjykata e shkallës së parë lidhur më vendosjen sipas aktgjykimit të ankimuar del te ketë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me 3 kushtet ligjore që është dashur që të plotësohen për nxjerrje të një aktgjykimi të tillë, të cilat i pranon si të ligjshme edhe kjo Gjykata e Apelit, pasi që në rastin konkret qartë rrjedh se të paditurit i ishte dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja –Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi, nga provat e bashkangjitura padisë haptazi dhe qartë del themelësia e kërkesëpadisë dhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësja.

Prandaj këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe Gjykata e Apelit e cila vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes), sepse janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 150 të LPK-së.

Te pathemeltë Gjykata e Apelit i vlerëson pretendimet ankimore të palës ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur prova të mjaftueshme që të bie aktgjykim për shkak të mosbindjes/padëgjueshmërisë, sepse në gjykatë është prezantuar marrëveshja gjyqësore-P..... ku i padituri ka pas për obligim që për çdo muaj të paguaj nga 50 euro, të cilën gjë e ka bërë dhe vazhdon që ta bëjë, me çka për rrjedhojë ka pas edhe zbatimin e gabuar të ligjit material, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës se shkallës së dytë në bazë të provave shkresore qartazi del se paditësja lidhur më dëmin të cilin këtu i padituri më fajin e tij i kishte shkaktuar të dëmtuarit B.R nga K..... në aksidentin e ndodhur më datë 08.06.2015, ja kishte kompensuar dëmin jomaterial dhe shpenzimet e procedurës të cilat ishin shkaktuar sipas padisë se evidentuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik C.nr. 304/17, në lartësi të shumës prej 2,074.00 euro.

Pajtimi gjyqësor të cilës i referohet i padituri si palë ankuese dhe pagesat të cilat kinse i njëjti ja ka paguar paditëses në emër të asaj marrëveshje, Gjykata e Apelit i vlerëson si pretendime tërësisht të pabaza, ngase kjo gjykatë me shikim në shkresa të lëndës konstaton se i padituri lidhur më këtë dëm të kërkuar nga paditësja nuk ka bashkëngjitur ndonjë marrëveshje/pajtim të lidhur në mes tyre lidhur me pagesat për rimbursim të këtij dëmi i cili i ishte paguar të dëmtuarit B.R nga K....., ndërsa fletpagesat të cilat këtu i padituri ja ka paguar kinse këtu paditëses për rimbursimin e dëmit ndaj të dëmtuarit të sipërpermendur, të cilt ja ka bashkëngjitur ankesës se ushtruar i referohen një lëndë tjetër e cila udhëhiqet sipas numrit të lëndës C.nr. 949/19, pra nuk kanë të bëjnë asgjë me lëndën C.nr. 304/17 në bazë të se cilës nga këtu paditësja ishte kompensuar i dëmtuari B.R nga K.....

Prandaj si shkak i hetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale. I drejtë del te jetë edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është marrë në pajtim me nenin 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata e Apelit në bazë të nenit edhe nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7220/2022, me datë 02.12.2024

Kryetari i kolegjit
Qerim Ademaj, d.v.